

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kontrabandë botoksi, biznesmeni i njohur përballet me akuzat - REPORT.AL
ADRESA	https://report.al/kontrabande-botoksi-biznesmeni-i-njohur-perballet-me-akuzat/
BURIMI	report.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 17:21:33 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 17:13:52 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a82c2dd6c494228e3c1a03a3baaea41623bb8ed079dca3f31c260ee7b354215a
TEKSTI	3615dc2701d6c2b3b2b3bb2f318fd747caab3f47f73ab382d042f1e9a47025a4
PAMJA	a162a721b3700cae68086ae84c719192e9672396cacdf14265e6eb718a6a978b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	055b33a027d6f6eff9dc4cf74238b36c126b1652a52f58025889cc138d972618
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	9515102868483048fab913125dfd13516db18986db3bd96a2369642ebf1c0d96
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/055b33a027d6f6eff9dc4cf74238b36c126b1652a52f58025889cc138d972618>

PAMJA E FAQES


Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Home Aktualitet

Kontrabandë botoksi, biznesmeni i njohur përballet me akuzat

by Lajm Lajm — September 16, 2026 in Aktualitet, Kryesore

0
SHARES

Share on Facebook

X Share on Twitter

Nga Elton Qyno

Një dosje hetimore që bën fjalë për "kontrabandim të medikamenteve mjekësore" dhe "fshehjen e të ardhurave financiare" është regjistruar në Gjykatën e Tiranës, me të pandehur Dritan Gremin dhe shoqërinë juridike "Gremi Wellness".

Çështja penale me emrin e biznesmenit të disa klinikave estetike dhe 11 bizneseve të hapura në Tiranë dhe Elbasan, është publikuar si i pandehur në seancat gjyqësore që Gjykata e Tiranës ka planifikuar të gjykojë më 22 shtator 2026.

Kujtojmë se në muajin tetor 2025, Dritan Gremi u shfaq edhe si kandidat i pavarur për të garuar në zgjedhjet për kryetar bashkie në Tiranë, zgjedhje këto që nuk u zhvilluan kurrë.

Siç mëson gazetari Elton Qyno, dosja me 2 të pandehur është ende në fazën e shqyrtimit gjyqësor në seancën paraprake dhe gjyqtare e çështjes është caktuar përmes shortit elektronik, Amarilda Sulaj.

Sipas dosjes hetimore, të pandehurit Dritan Gremi dhe shoqëria e tij "Gremi Wellness" dyshohet se kanë kryer kontrabandë të medikamenteve mjekësore, kryesisht "Butox", me princip aktiv "Botulinum toxin".

Ky medikament mjekësor aktualisht nuk është i pajisur me autorizim për tregtim në Shqipëri.

Ndërkohë, edhe pajisjet mjekësore që vendosen në treg në Republikën e Shqipërisë duhet të regjistrohen në Regjistrin Kombëtar të Pajisjeve Mjekësore, procedurë kjo që mbahet nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore.

Në klinikë janë gjetur pajisje mjekësore të pacertifikuara dhe kryeshin injeksione nga persona të cilët nuk janë mjekë, por estetiste. Fakt ky i konfirmuar nga disa pacientë që janë pyetur.

Shkeljet janë konstatuar gjatë një këqyrjeje fizike në ambientet e "Gremi Clinic", që është kryer nga policia gjyqësore më datë 17 korrik 2025.

Gjithashtu, sipas dosjes hetimore, po në vitin 2025, gjatë një raporti të Kontrollit Tatimor mbi këtë biznes, është konstatuar se shoqëria juridike "Gremi Wellness" ka detyrime tatimore dhe gjoja të papaguara që shkojnë në shumën financiare prej 285 milionë lekësh të vjetra.

Kjo kompani dhe pronarët e saj, bashkëjetuesit Dritan Gremi dhe Anduena Çela, prej janarit 2021 kanë operuar si biznes me objekt tregtar fillimisht për "...aktivitete të këshillimit për biznes dhe këshilla të tjera për menaxhimin...".

TË FUNDIT

Kontrabandë botoksi, biznesmeni i njohur përballet me akuzat

SEPTEMBER 16, 2026

Turpi ka emër: Gjykata e Hagës dhe të marrët politikanë

SEPTEMBER 16, 2026

Plagosje me armë zjarri në Durrës

SEPTEMBER 16, 2026

Arkitekt i vilës së Ballukut/ Olsi Eftimi del nga SPAK, "kyç" gojën për gazetarët

SEPTEMBER 16, 2026

Tubacioni i Bogovës pëson defekt, Berati, Kuçova dhe fshatrat përreth mbeten pa ujë

SEPTEMBER 16, 2026

Besmir Beja i Doganave rrit taksën e zhdoganimit të makinave me urdhër të brendshëm

SEPTEMBER 16, 2026

PD ripërsërit kërkesën: Kuvendi të miratojë rezolutën për dënimin e gjenocidit serb në Kosovë

SEPTEMBER 16, 2026

Kryeministri Kurti për dënimin e ish-krerëve të UÇK-së/ I padrejtë, askush se njollos dot luftën e shqiptarëve për liri

SEPTEMBER 16, 2026

A shuhet dënimi i ish luftëtarëve të UÇK-së duke shkruar Gjykatën Speciale të Kosovës në Hagë?

SEPTEMBER 16, 2026

Dënimi i 4 ish-liderëve të UÇK/ Kryegjykatësi Smith tregon me detaje rastin e zhdukjes së Behajdin Allaqit

SEPTEMBER 16, 2026

Por në muajin nëntor 2025, objekti i kompanisë ndryshoi, duke shtuar aktivitetin në fushën e menaxhimit të strukturave të ndryshme në fushën e shëndetësisë.

"...kryesisht klinikave të kirurgjisë estetike dhe trajtimeve të tjera estetike, duke marrë përsipër menaxhimin në total të burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me pacientët (çaktimi i orareve të vizitave, të orareve të ekzaminimeve, të trajtimeve estetike dhe kirurgjikale, promovimet dhe ndjekja e politikave për zgjerimin e nr. të pacientëve etj...)" - thuhet në objektin e veprimtarisë tregtare të ndryshuar në muajin nëntor 2025.

Por vetëm pak ditë pasi Dritan Gremi i ndryshoi objektin e veprimtarisë tregtare kompanisë "Gremi Wellness", ai, më 27 nëntor 2025, vendosi t'ia shesë 100 për qind të aksioneve të kësaj kompanie bashkëjetueses së tij, Anduena Çela.

Kontrata e shitjes është firmosur para noteres Aida Hoxha në Tiranë dhe shitja është bërë kundrejt një çmimi prej 1 milion lekësh të vjetra.

Por aktualisht, në emër të Dritan Gremi vijojnë të jenë disa kompani të tjera si "Gremi Longevity Center", "My Albania News", "Gremi Sweet Bread", "La Belle Noiseuse", "Hotel Serenity", "Gremi Clinic", "Dritan Gremi", "Viaggiare e Sorridere" e të tjera.

Tags: botoks dritan gemin Ko trqbandë

Previous Post

Turpi ka emër: Gjykata e Hagës dhe të marrët politikanë

Lajm Lajm

report.al


REPORT.AL

Portali report.al është një media online e pavarur që sjell lajme, analiza dhe informacione të sakta në kohë reale. Me fokus tek transparencia dhe vërtetësia, portali synon t'u ofrojë lexuesve shqiptarë një burim të besueshëm lajmesh nga politika, ekonomia, shoqëria dhe ngjarjet ndërkombëtare.

RUBRIKAT

- Aktualitet
- OP-ED
- Politike
- Rajon
- Showbiz
- Sociale
- Shëndet
- Sport

MË TË KLIKUARAT



E rëndë, elektrikisti që humbi jetën gjatë punës në Belsh nuk kishte asnjë mjet mbrojtës

01

0 SHARES



Parandalohet ngjarja e rëndë në Rrogozhinë, arrestohet i riu që kanosi me kallashnikov 35-vjeçarin

0 SHARES



Skandali/ Policia rrugore shoqëron kamionët e Alesios në orarin e ndalimit të qarkullimit

0 SHARES

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.